

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEĐNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e dytë publike me qytetarë për Raportin e Punës së kryetarit të komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, për vitin 2023, e mbajtur më 28 dhjetor 2023, në ora 15:00, në Sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, drejtorë komunalë dhe qytetarë të shumtë.

Qemajl Aliu: Përvendetje për të gjithë juve, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim, falënderoj edhe bashkëpunëtorët që janë prezent këtu, pa të cilët këto projekte dhe këto punë nuk do të ishin implementuar.

Po shoh që ka edhe asambleistë këtu, përvendetje për kolegët asambleistë, e shumë respekt për qytetarët e sidomos për mërgimtarët që tani po kalojnë pushimet dimërore pranë familjeve të tyre me shpresën që këta po shohin ndryshime pozitive në Komunën e Shtimes, për të cilat ne po angazhohemi bashkërisht pa u ndalur 24 orë, çdo ditë.

Falemnderit shumë, fillojmë me prezantimin pa ju marr kohë, e më vonë fillojmë edhe me pyetje përgjigje, por edhe me bashkëbisedim.

Po e nisim me një lajm, që është i fundit por që për shkak të qeverisjes së mirë, të drejtë dhe ligjore, Komuna e Shtimes është në mesin e shtatë komunave që ka përfomuar më së miri, gjatë qeverisjes dyvjeçare dhe si shpërbirim i kësaj, ne do ta përfitojmë një grant, që quhet granti i performancës së mirë, që do të jetë diku 700 mijë euro më shumë për qytetarët e komunës sonë dhe kjo si efekt i qeverisjes së mirë dhe ligjore.

Buxheti për vitin 2023 është 9.9 milionë euro dhe të hyrat janë rrëth 100 mijë euro më shumë. Realisht, në vitin e parë të qeverisjes sonë e kemi gjetur buxhetin në 7.7 milionë, tani është rrëth 10 milionë euro, dhe krejt kjo vjen si pasojë e qeverisjes së mirë edhe në nivelin republikan dhe administrativ dhe mbledhjes së taksave nga Ministria e Financave, përkatësisht nga ministri Hekuran Murati dhe qeveria Kurti dhe kjo reflektohet edhe në rritjen e buxhetit për të gjitha komunat, e në këtë rast edhe për Komunën e Shtimes, që brenda dy viteve është diku 2.2 milionë euro më shumë.

Subvencionet në bujqësi. Ne jemi zotu që subvencionet në bujqësi deri në fund të mandatit do t'i qojmë deri në 500 mijë euro, nëse nuk gaboj, nga qeverisja e kaluar i kemi gjetur vetëm 40 mijë euro kur kemi ardhur. Këtë vit kemi rritje 100%. Vitin e parë e kemi rritur nga 40 mijë në 150 mijë

euro. Këtë vit janë 300 mijë euro, me shpresën që vitin e ardhshëm dhe vitin e katërt të arrijmë 500 mijë euro në subvencione, të ndara për buqit e Komunës së Shtimes.

Sa i përket investimeve kapitale, këtë vit kemi përvuuar parkun në Davidovc, shpresoj shumë kush nga ju e keni parë, përvimi ka ndodhur në pranverën e hershme së bashku me kryeministrin dhe miqtë tanë nga Gjermania, që ka kushtuar 144 mij euro.

Rruja e Vojnovcit është një rrugë që është ndërtuar këtë vit, me një vlerë 95 mijë euro, rrugë kjo që e lidh fshatin Vojnovc dhe fshatin Topliqan të Lipjanit.

Shtigjet për ecje dhe çiklizëm, po ashtu është një projekt-investim 90 mijë euro, që është implementuar në fshatin Rashincë dhe që ka dal një projekt shumë i bukur.

Po ashtu rrugën e tranzitit, që nuk ka 3 orë, që së bashku me ministrin Liburn Aliun e me bashkëpuntorë e përvuruam, secili prej jush keni pasur mundësi me e pa këtë rrugë, një rrugë që ka qenë e demoluar dhe e shkatërruar. Jam shumë krenar dhe i lumtur që dy vitet e para të qeverisjes sonë, me përkrahjen e Ministrisë së Financave tash është rikthyer dhe po shpresoj që sikurse kjo rrugë edhe shumë rrugë tjera që do ta kenë fatin e rivitalizimit por edhe shtimin e rrugëve të reja.

Sa i përket arsimit, kemi patur shumë investime, përveç grantit të arsimit që është diku mbi 3.5 milionë euro. Ne për arsimin ju kemi thënë dhe jemi zotu që e kemi prioritet dhe për çdo vit ne investojmë plus gati 400 deri 500 mijë euro. Këtu do t'i përmendim disa projekte infrastrukturore që kemi investu. Është projekti 200 mijë euro që është, që është investu në shkollën fillore “Emin Duraku”, në Shtime, është në gjimnazin ‘Naim Frashëri’, ku është investuar 107 mijë euro, çerdhja në Muzeqinë, ka qenë një objekt publik që është lënë pasdore, aty i kemi investu 70 mijë euro, tashmë është në fazën finale dhe shumë shpejt pritet me e funksionalizu dhe do të jenë të shërbim të fshatit Muzeqinë dhe fshatrave përrreth. Si dhe renovimi i objekteve arsimore në shumicën e shkollave fillore nëpër të gjitha fshatrat për fillimin e viti shkollor në shtatorin që e kaluam.

Kur jemi te arsimi, kemi investu edhe nëpër shumë kabinete nëpër shkolla. Ne e dimë që arsimi cilësor nuk mjafton me pas vetëm objekte moderne, por duhet të ketë edhe laboratore profesionale. Në kuadër të saj kemi përvuuar kabinete në vlerë 115 mijë euro, në shkollën profesionale, në gjimnaz si dhe në shkollën e fshatit Gjurkovc.

Pastaj kemi investu në një park dhe rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Petrovë, që është në shumën 32 mijë euro. Ringjallja e Shtëpisë së Kulturës, ju e keni që pothuajse Shtëpia e Kulturës nga një sallë që më shumë është shfrytëzuar për mbledhje komemorative dhe për takime publike e politike dhe jeta kulturo-artistike ka qenë e varfér, ne jemi mundu dhe ja kemi dalë që pothuajse çdo muaj ka pasur nga një shfaqje, kështu që jemi mundu me e gjallëru me shfaqje, qoftë teatrale, reciatale.

Instalimi i sistemit të alarmit në gjashtë shkolla, dhe kamerave në shtatë shkolla, në një vlerë prej 23 mijë eurove, sepse fatkeqësisht disa herë kemi pasur edhe thyerje dhe vjedhje të shkollave, kështu që kjo është edhe një siguri dhe monitorim i mirë i shkollave.

Në kuadër të shërbimeve publike kemi investu në rregullimin e vendndaljeve të autobusëve, diçka që ka munguar në komunën tonë. Në gjashtë fshatra tashmë janë vendosur, presim edhe në shtatë fshatra në vitin që vjen. Është një projekt me një vlerë 70 mijë euro dhe ne do të vazhdojmë deri sa t'i pajisim të gjitha stacionet e autobusëve nëpër fshatra por edhe në qytet.

Kanalizimi dhe ndriçimi, rregullimi i ndriçimit publik në dhjetë fshatra, normal jo në total por me lagje të caktuara si dhe kanalizimi në pjesë të caktuara, aty ku ka pasur më shumë nevojë dhe prioritet në nëntë fshatra.

Trotuare të reja, vetëm këtë vit i kemi bërë 6 kilometra trotuare të reja nëpër fshatra dhe në qytetin e Shtimes. Po ashtu edhe dhomën mike, është kjo një dhomë që është investu nga Komuna e Shtimes dhe nga një donator amerikan, në Stacionin e Policisë këtu në Shtime, ku viktimat e dhunës, aty kanë mundësi me e pas një trajtim të dinjitetshëm.

Parku argëtues në çerdhen “Albiona Asllani”, po ashtu ishte një investim i yni këtë vit. Furnizimi me barna esenciale, kjo është për kolegët që vijnë nga QKMF-ja, ne e kemi gjetur me një investim rrëth 26 mijë euro, ne vitin e parë e kemi quar në 60 mijë euro dhe këtë vit janë 102 mijë e 735 euro shto faktin këtu që edhe nga Ministria e Shëndetësisë furnizohen, por edhe ne për qytetarët e Komunës së Shtimes, që qytetarët pas vizitës te mjeku mos të ketë nevojë të blejë barna, ne e kemi furnizuar si asnëherë më parë, janë pra 102 mijë euro para nga taksat e Komunës së Shtimes për të gjithë qytetarët për barna.

Ura dhe rrugë, rregullimi i urës dhe asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat Pjetërshticë, Carralevë, Zborc dhe Godanc i Epërm, është një ndër projektet që më së shumti e dua, sepse përveç akseve historike që ka Komuna e Shtimes, ne mendojmë që përmes këtij aksi që fillon në Pjetërshticë, Carralevë, Zborc, Godanc i Epërm, Godanc i Poshtëm e deri në Gjurkovicë, do të ketë mundësi që kjo zonë me u zhvillu edhe me e pas një prosporitet për banorët e atyre zonave, dhe unë mendoj që në një të ardhme shumë të shpejtë, të gjithë qytetarët që e lëshojnë autostradën nga Kryqi i Komoranit, që duan të vijnë në Shtime, përkatesisht në Ferizaj, në Shkup, në Aeroport por edhe në Lipjan e Prishtinë, do ta përshkruajnë këtë rrugë, që do të jetë rrugë ndërurbane.

Investim tjetër ka qenë rruga që ka filluar në fillim të vjeshtës te Kulla e Lirisë, qytetarët e Reçakut e dinë, dhe tashmë është përfunduar, para disa ditësh është asfaltuar edhe shtresa e fundit, do të jetë një rrugë dinjitoze, që do t'a përshkruaj trajektoren nga memoriali deri te kulla dhe do të kalojë edhe rrëth përmendoreve të dëshmorëve, do të ketë edhe trotuar edhe ndriçim, kështu që është një simbolikë e mirë për t'a nderuar atë ngjarje e cila është sa e dhimbshme, por edhe na bënë krenarë për kthesën historike që e ka pas përlirinë dhe shtetin që e gëzojmë.

Është çerdhja në fshatin Godanc, ne para pak muajve jemi dëshmitarë që e kemi filluar çerdhen së bashku me kryeministrin Kurti dhe me ministren Arbërie Nagavci, në vlerë prej 414 mijë euro. Para pak kohësh vërejta që tashmë ka përfunduar ndërtimi i vrazhdë dhe vitin tjetër me këtë dinamikë të punës presim të përfundon dhe të fillon puna në këtë çerdhe, që do të jetë çerdhe për tri fshatra, përfunduar Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm dhe po ashtu edhe për Lagjen e Pajtimit.

Rregullimi i sheshit, gjysma e sheshit nga rruga “12 Qershori” deri te “William Wolker”, tashmë ka përfunduar.

Kemi edhe shumë e shumë punë e projekte të tjera që kanë përfunduar dhe janë në fazë të punimeve por edhe të përfundimit.

Nëse ju qytetarë të ndëruar keni ndonjë pyetje apo diçka tjetër, jam i gatshëm t'u përgjigjem

Nazmi Hyseni, Godanc i Epërm: Më së pari përshëndetje për të gjithë. Të mira dhe të nevojshme, por mundemi me gjetë kajde çdo kush, por krejt janë të nevojshme këto që i keni bërë ju me planet

e juaja i keni realizu. E përmendët punën e kanalizimeve të ujrave, prej Godancit të Epërm e te poshtë, na kanë thanë që do të kryhen edhe do projekte tjera nëpër ato rrugicat tona. Ne si familje kemi problem atje lart, kullohen ujërat atmosferike, kalon një rrugë publike. Kam paraqitë kërkësë në qeverisjet e mëhershme, jo kemi mundësi, jo s'kemi mundësi, kemi bërë prap që një vjet apet janë shty. Në këto projektet që keni kry deri tash sigurisht i keni harxhit paret, por masi ju ka dal zani që keni ba pare koxho si shumë sivjet, do ta bëjmë një kërkësë edhe njëherë ndoshta na realizohet urime edhe për vitin e ardhshëm, ishalla keni sukses sikur këtë vit edhe në vitet tjera! Falemnderit!

Qemajl Aliu: Falemnderit për pyetjen! Pak më herët e përmenda është një projekt që është financuar nga Ministria e Infrastrukturës, pikërisht për kanalet kulluese për problematikat që keni, është një projekt shumë i mirë. Fatkeqësisht kemi pasur pak pengesa, qoftë për problemet që ka pas operatori, qoftë edhe për problemet që janë shfaq në implementimin e projektit gjatë kalimit të projektit nëpër prona private. Megjithatë ai projekt do të implementohet deri në fund dhe krejt ato ujëra që mblidhen pikërisht në lagjen e juaj dhe vazhdojnë mes fshatit Godanc dhe fshatit Bregu i Zi, e që kanalizohen te asfalti këtu në Davidovc, do ta gjejnë trajtimin e duhur. Sa i përket kërkësave pastaj, qoftë veç e veç, qoftë për asfaltim, qoftë për ndriçim apo kanalizim, ju e keni parë që në praktikën tonë dyvjeçare, ne kemi bërë ndriçime publike, nuk është që ne i hartojmë projektet e buxhetet sikur në praktikat e kaluara, ne shkojmë në secilin fshat në secilën shkollë dhe i marrim prioritetet direkt nga nevojat e qytetarëve, ato i implementojmë në bugjet, e pastaj i realizojmë. Qoftë edhe një kërkësë që do të vijë nga ju, patjetër që do të trajtohet për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, e aq më shumë për një vëlla e familjar të dëshmoris, që ne kemi respekt të veçantë. Kështu që adresone, nëse nuk e keni adresu deri tash dhe unë jam këtu por edhe drejtoret që shumë shpejt besoj, brenda vitit të ardhshëm mund të gjejë përkrahje dhe zgjedhje.

Lulzim Rashtit, Godanc i Epërm: Nuk kam kanalizim, 250 metra është larg aty, e kam ba kërkësen, kurgjo s'mu ka kthy. Edhe diçka, pram mi kanë vjedhë dy lop, në mesnatë.

Valmir Bislimi, Godanc i Poshtëm: I rrespekt për punët dhe shpresoj shumë edhe për punë tjera të mira në komunën tonë, po masi jemi te puna e kanalizimit, deshta edhe unë me e ba një pyetje. Rruga "Topilla", kemi problem me punë të kanalizimit, por ne problem tjetër më serioz është që kemi mungesë të furnizimit me energji elektrike, është rrryma shumë shumë e dobët, nuk e di a mundeni me ba diçka zgjidhje Drejtoria e Shërbimeve Publike për punën e rrymës. Se ndoshta e kemi prioritet edhe para kanalizimit. Këto janë dy kërkesa të mia, shpresoj që t'më mirren parasysh?

Qemajl Aliu: Lulzim Rashiti, falemnderit. Ne e dimë që ka shumë nevojë e shumë kërkesa, ne do të mundohemi që ato me prioritet dhe në mënyrë të barabart t'i ndajmë. Pak a shurnë buxheti është i përcaktuar për secilin fshat dhe në secilën lagje të qytetit. Ne kemi kapacitete të kufizuara, me të cilat operojmë, ndoshta për me i zgjidh krejt kërkësat dhe nevojat e qytetarëve duhet me e nda gjysmën e fondeve për komuna, vetëm Komunës së Shtimes. Megjithatë me këto kapacitete që kemi do të mundohemi që, që prioritetin dhe kërkësen që kanë qytetarët, duke mos i lënë anash as zotimet tona, do të mundohemi t'i implementojmë. Ne e dimë që trashëguam infrastrukturë të papërmbyllur dhe ka nevojë shumë, e sidomos në kanalizim i cili është edhe i kushtueshëm, por edhe ju duhet ta keni mirëkuptim tonë, që të gjitha përnjëherë, nuk bëhen. Ne jemi vetëm në vitin e dytë të mandatit tonë dhe besoj që gradualisht me këtë dinamikë do të përpinqemi që kryesisht të gjitha nevojat kryesore prioritare t'i zgjidhim.

Sa i përket asaj çështjes së sigurisë, na vie keq por policia dhe organet e sigurisë e prokuroria duhet të jenë të krye të detyrës, për këto vjedhje që janë fenomene jo pak të rralla. Unë e përmenda që edhe shkollat janë thyer disa herë, unë do ta adresoj si shqetësim edhe në takimet e rregullta që kemi me komandantin e policisë, me shpresën që kryerësit të kapen dhe të vehen para drejtësisë.


Sa i përket qytetarit Valmir Bislimit, te kanalizimi është e njëjta përgjigje, duhet ta adresoni në drejtorinë e urbanizmit edhe ne do të mundohemi ta përfshijmë sa më shpejtë që është e mundur. Ndërsa sa i përket rrymës, është një problematikë shumë e madhe në komunën tonë, ju duhet t'a dini por edhe qytetarët, që fatkeqësish ne nuk kemi asnje kompetencë në menagjimin as të rrjetit as të furnizimit me energji elektrike, kjo është ekskluzivisht çështje e KEDS-it che KESKO-s, të cilat janë kompani private. Edhe kërkesat e tona, në disa projekte që kemi pas, në qendër të Shtimes, për me naj hjek ato shtyllat elektrike e ato kabllot edhe aty nuk na janë përgjigj. Ata thojnë kemi planet dhe projektet tona të pavarura dhe ne nuk ndikohemi. Gjendja është e rëndë, ne kemi ankesa nga të gjitha anët, qoftë për rrjet, qoftë për energji të voltazhit të ulët, por që fatkeqësish ne nuk kemi asnje mundësi. Shqetësimet tona ne i adresojmë deri te drejtori turk, që është në qendër por realisht nuk jemi të kënaqur as me vëmendjen e as me investimet që po bëhen. Duhet t'a kemi mirëkuptimin që pushteti lokal nuk ka qasje nëasnje segment në këtë aspekt, përveçse me na ardhë keq, sepse s'kemi mekanizma ekzekutiv.

Valmir Bislimi: Edhe pse kemi bërë kërkesë publike me shkrim, ata nuk e kanë marrë përsipër. Unë e di që nuk është kompetencë e Komunës kjo, por e mora si lloj adresimi që përmes Komunës, të mundohemi me bë një zgjidhje.

Qemajl Aliu: Për të gjithë qytetarët, po ju tregoj një mënyrë adresimi të problemit, një peticion me gjithë nënshkrimet e qytetarëve të lagjes, të dorëzohet në zyret në Shtime, në drejtorinë në Ferizaj, por edhe një kopje te zyra ime, me shpresën që duke ju bërë një presion pozitiv mund të realizohet. Dhe një mënyrë tjetër, është një numër kujdestarie që e ka KEDS-i, që shpesh herë disa qytetarë të një lagje të caktuar adresojnë kërkesën dhe shqetësimet e tyre dhe janë marrë parasysh. Këto janë mënyrat, nuk di që ka mënyra tjera sinqerisht.

Pasi nuk kemi pyetje tjera nga qytetarët, unë edhe njëherë kisha dashur t'ju falënderoj secilin veç e veç që keni gjetë kohën dhe që jeni prezent. Duke shpresuar që viti që po vjer, do të jetë më i mirë për të gjithë ne. Mirëupafshim në takimet e tjera së bashku!

Mbledhja ka përfunduar në ora 16:15
















LISTA E PJESËMARRËSVE NË DEBATIN PUBLIK ME QYTETAR
KRYETARI I KOMUNËS QEMAJL ALIU - RAPORTI I TË ARRITURAVE PËR VITIN 2023

Shtime, më 28 dhjetor 2023 (e enje)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Afzim Xhafer Hiti	SHTAU, E. DUTARË	
2	Muhamet Ademaj	Thellësia e mesme profesionale IAAP	
3	Salih Lloshi	Diaspora	
4	Veliq Alawi	Qytetar	
5	Hani Kurishi	L. Shtime	
6	Eduar Hizani	Qytetar	
7	Fatmir Shogiri	Qytetar	
8	Shabetai Isenay	PETAR	
9	Dolip Ismajli	Petrov	
10	Afzim Ademaj	Petrov	
11	SANDE SADIKI	KOMUNA SHTIME	
12	Fenide Roxha	Komuna Shtime	
13	Gentiana Mehmeti	Komuna Shtime	
14	Sadberk Halili	Komuna Shtime	
15	Vahide Ejupi	Komuna Shtime	
16	Bllozmi Mydemi	Gadime i Epërm	
17	Donika Begiri	KOMUNA E SHTIMËS	
18	Ergjete Veluri	Keshilli komunë	

19	Gzim Gashi	Shtepia e Komunitetit shme	Ggħix
20	Hamit Paqaziti	Shtepia e Komunitetit - Shtime	Għixxu koll
21	Vittorje Bissani	Qytelar	Għixxu koll
22	Mustafà Halili	Qytelar	Għixxu koll
23	FLAMUR MUHADIN QU	Q. V.	F. M
24	Nexxixie Zaq	Q.	Għixxu koll
25	Frerxi Ramadani	Kwendi Komunali	R. P. J.
26	Thasur Adami	Qytelar	Għixxu koll
27	Mersim Selmani	Aktiu	Għixxu koll
28	YISAR TERSHAN	QWIEQE	Għixxu koll
29	SELMAN RAMADAN	QYTETAR	Għixxu koll
30	Lukim Bishki	Għidu jippe	Għixxu koll
31	JRIT ON L-ΣTĀJ	QYTETAR	Għixxu koll
32	SHPENQ KOKOċċA	QYTETAR	Għixxu koll
33	ARBEN DELIU	QYTETAR	Abbi Jekk
34	ALBUJNÉ Għanni	JISPĒKTORE	Għixxu koll
35	Steinoller Danti	Zaq JIPPOX	Għixxu koll
36	XHEZA! R-MURTEZI	QYTETAR	Għixxu koll
37	Dha fuq Ghaxi	Qytetar	Għixxu koll
38	Melha Mifexx	KL	Għixxu koll
39	Blokka	Shtime	Nebukute Bixxu
40	Zgħejż Għażiex	Mercantznej	Għixxu koll

41	Sophia Drahmane	Diaspona	Gadzhi,
42	Yulista Alia	Shtime	Yuliz,
43	Hanife Ali-Aibar	Petrov-Diaspa	Hanife
44	Mirnemə Hysenov	Petrov	Mirneni
45	Lulzim Sahiti	Shtime	Jufis
46	Lulzim Muharrimi	Shtime	Lilim
47	Donieta Gorrolli	Shtime / Rosinca	D.Gorrolli.
48	Vlora Hyseni	Shtime / Muzeqine	Hysenoff
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			
58			
59			
60			
61			
62			
63			